



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 11 Shkurt 2022

Nr: 65

V E N D I M

P Ë R

**REGJISTRIMIN E KANDIDATIT PËR KRYETAR NË BASHKINË DURRËS TË
PROPOZUAR NGA KOALICIONI “SHTËPIA E LIRISË” (SH-L), Z. ARDIAN MIHAL
MUKA PËR ZGJEDHJET E PJESSHME VENDORE PËR KRYETAR BASHKIE TË DATËS
6 MARS 2022**

Në mbështetje të Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 13 438, datë 20.01.2022 “Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie për disa njësi të qeverisjes vendore”, të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, nenit 67, pika 2, nenit 72, nenit 73, nenit 165, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, nenit 5, pika 4, shkronja “a” të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të udhëzimit nr. 01, datë 23.12.2020, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit” si dhe të vendimi nr. 2, datë 22.1.2022 “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë, që do të zhvillohen më datë 6 Mars 2022”, pasi shqyrtoi dokumentacionin e depozituar për regjistrimin e kandidatit për kryetar bashkie për zgjedhjet e pjesshme vendore që do të zhvillohen në datën 6 Mars 2022, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve



Data: 11 Shkurt 2022
Nr. 65

“Për regjistrimin e kandidatit për kryetar në bashkinë Durrës të propozuar nga Koalicioni “Shtëpia e Lirisë” (SH-L), z. Ardian Mihal Muka për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”

V Ë R E N:

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 13 438, datë 20.01.2022, ka caktuar datën 6 Mars 2022, për zhvillimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie në Bashkinë Shkodër, Bashkinë Dibër, Bashkinë Durrës, Bashkinë Vorë, Bashkinë Rrogozhinë dhe Bashkinë Lushnjë.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 46, datë 4.2.2022, “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e Koalicionit “Shtëpia e Lirisë”, (SH-L) për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”, ka regjistruar si subjekt zgjedhor pjesëmarrës në zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, koalicionin e partive politike “Lëvizja Socialiste për Integrim” dhe “Partia Demokristiane e Shqipërisë”. Partia udhëheqëse e koalicionit është “Lëvizja Socialiste për Integrim”.

Në zbatim të pikës 2, të vendimit nr. 2, datë 22.1.2022 “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë, që do të zhvillohen më datë 6 Mars 2022”, koalicioni “Shtëpia e Lirisë” ka depozituar në KQZ kërkesën për regjistrimin e z. Ardian Mihal Muka, si kandidat për kryetar në bashkinë Durrës.

Në bazë të nenit 67, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve regjistron kandidatët për kryetar në bashkinë Durrës, pasi bashkia Durrës, nuk administrohet nga një KZAZ e vetme.

Bashkëlidhur kërkesës është depozituar dhe dokumentacioni përkatës si më poshtë listuar:

1. Kërkesë e partisë politike, për regjistrimin e kandidat për kryetar, në bashkinë Durrës.
2. Kopje të dokumentit të identifikimit të kandidatit për kryetar bashkie.
3. Deklarimi i llogarisë bankare të posaçme të kandidatit, sipas Model 03/1 të Udhëzimit.
4. Deklarata e kandidatit ku deklarohen të gjitha elementet e përcaktuara në shkronjat “b” e “c”, të nenit 72, të Kodit Zgjedhor, sipas Model 05.
5. 3 (tre) vërtetime të Kuvendit të Republikës, nëpërmjet së cilave vërtetohet zotërimi i mandateve nga deputetë të subjektit zgjedhor "Lëvizja Socialiste për Integrim".
6. Jetëshkrimi i kandidatit për kryetar bashkie, sipas Model 07 të Udhëzimit.
7. Formulari i vetëdeklarimit të kandidatit për kryetar në bashkinë Durrës, z. Ardian Mihal Muka, me nr. 14 unik, datë 9.2.2022.
8. Procesverbal i dorëzimit të dokumentave, sipas Model 08 të Udhëzimit.

Z. Ardian Mihal Muka, në përputhje me parashikimet e nenit 5, pika 4, shkronja “a” të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ka



depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i kryetarit të bashkisë.

Nga verifikimi prima facie i formularit të vetëdeklarimit të kandidatit për kryetar në bashkinë Durrës, Qarku Durrës, z. Ardian Mihal Muka rezulton se, nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit, nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, me shkresën nr.677 prot., datë 10.02.2022 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr.676 prot., datë 10.02.2022 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për kandidatin për kryetar bashkie në bashkinë Durrës, Qarku Durrës, që ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë për verifikimin e të dhënave për kandidatin për kryetar në bashkinë Durrës, Qarku Durrës, z. Ardian Mihal Muka.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 1490/1 prot., datë 10.02.2022, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për kryetar në bashkinë Durrës, Qarku Durrës, z. Ardian Mihal Muka, i cili rezulton se nuk ka të regjistruar dënim penal të formës së prerë, është i padënuar.

Referuar ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, të dhënat e deklaruara në formularin e vetëdeklarimit dhe informacionit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, për kandidatin për kryetar në bashkinë Durrës, Qarku Durrës, z. Ardian Mihal Muka, nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin e kandidatit, për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 73, pika 1, të Kodit Zgjedhor, në mbledhjen e datës 11.2.2022, verifikoi dokumentacionin e kandidatit për kryetar në bashkinë Durrës, të depozituar nga koalicioni “Shtëpia e Lirisë” (SH-L) dhe konstatoi se ishte në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenin 67, pika 2, nenin 72, 165, pika 3 dhe 173 të Kodit Zgjedhor.



PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, nenit 67, pika 2, nenit 72, nenit 73, nenit 165, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, nenit 5, pika 4, shkronja “a” të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të udhëzimit nr. 01, datë 23.12.2020, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit” si dhe të vendimi nr. 2, datë 22.1.2022 “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë, që do të zhvillohen më datë 6 Mars 2022”, pasi shqyrtoi dokumentacionin e depozituar për regjistrim e kandidatit z. Ardian Mihal Muka, për kryetar bashkie për zgjedhjet e pjesshme vendore që do të zhvillohen në datën 6 Mars 2022, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

VENDOSI:

1. Të regjistrojë si kandidat për kryetar në bashkinë Durrës, për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, z. Ardian Mihal Muka të propozuar nga koalicioni “Shtëpia e Lirisë” (SH-L).
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga data e shpalljes të këtij vendimi, në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

